

# Trajtimi i Rasteve të Lirimit me Kusht nga Gjykata Supreme e Kosovës: *një analizë për vitin 2024*

Dhjetor 2024



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES

## RAPORT

# TRAJTIMI I RASTEVE TË LIRIMIT ME KUSHT NGA GJYKATA SUPREME E KOSOVËS: NJË ANALIZË PËR VITIN 2024

Dhjetor 2024



© Grupi për Studime Juridike dhe Politike | Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike, dhjetor 2024.

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë ato të donatorëve, stafit, bashkëpunëtorëve, Bordit (eve) të Grupit për Studime Juridike dhe Politike. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike për kërkesa të tilla.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike | Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike

Rr. "Rexhep Luci", 16/1

Prishtinë 10 000, Kosovë

Uebsite: [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)

E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)

Tel/fax.: +381 38 234 456

Ky raport është publikuar nën kornizën e projektit "Human Rightivism", i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe i implementuar nga Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF). Opinionet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk reflektojnë ato të donatorit në asnjë mënyrë.



Embassy of Sweden  
Pristina

# TRAJTIMI I RASTEVE TË LIRIMIT ME KUSHT NGA GJYKATA SUPREME E KOSOVËS: NJË ANALIZË PËR VITIN 2024

## HYRJE

Instituti juridik i lirit me kusht është një procedurë ligjore që mundëson që të dënuarit të lirohen nga vuajtja e tërësishme e dënimit me burgim, duke ju kthyer jetës normale, familjes e shoqërisë. Qëllimi i aplikimit të lirit me kusht ka të bëjë me zvogëlimin e efekteve negative të burgosjes, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri, përgatitja e tij për jetë të përgjegjshme dhe mbrojtjen e shoqërisë përmes parandalimit të kryerjes së veprave penale.

Ndër arsyt kryesore për hartimin e një analize të tillë është fakti se në vitin 2023, më shumë se gjysma e kërkesave të të dënuarve u refuzuan nga Paneli e po ashtu shumica e ankesave ndaj vendimeve të Panelit nuk u aprovuan nga Gjykata Supreme. Kjo u bë shkak që të dënuarit t'i drejtohen edhe Institucionit të Avokatit të Popullit me pretendimet që kërkesat e tyre nuk janë shqyrtuar me kohë; nuk janë pajtuar me arsyet e refuzimit të kërkesave; vendimi ka përmbajtur fakte të cilat nuk i kanë konsideruar se bëhet fjalë për vet personin; vendimet kanë qenë shabllone, tek të cilat janë ndërruar vetëm te dhënat personale, etj.<sup>1</sup>

Prandaj, në këtë analizë përveç sqarimit të rëndësisë së institutit për lirim me kusht e bazës ligjore, do të prezantohet mënyra se si janë trajtuar rastet e lirit me kusht gjatë periudhës 1 janar - 31 tetor 2024 nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, vendimet e së cilës janë përfundimtare sa i përket kësaj procedure.

Nga 27 aktvendimet e publikuara në periudhën e lartcekur, rezultojnë se vetëm në një rast Gjykata Supreme ka aprovuar ankesën e të dënuarit në raport me refuzimin e kërkesave të tyre nga ana e Panelit për Lirim me Kusht. Kurse pjesa tjetër e aktvendimeve të gjykatës së shkallës së tretë kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike të vendimeve që i ka nxjerrë Paneli, çka lë të nënkuptohet se puna e këtij institucioni mund të vlerësohet pozitive dhe në përputhje me dispozitat që e rregullojnë institutin e lirit me kusht në vendin tonë.

Së paku në tri nga 27 rastet e analizuara, rezultojnë se Supremja ka vërtetuar vendimet e Panelit edhe pse të njëjtat janë marrë në kundërshtim me gjendjen faktike, përkatësisht me raportin e Ekipit Profesional të Qendrës Korrektuese. Po ashtu, ndonëse vlerësohet tejteje pozitive roli proaktiv i Gjykatës Supreme në publikimin e vendimeve gjyqësore, vetëm 1 nga 27 aktvendimet e analizuara është publikuar në të dy gjuhët zyrtare. Fakt tjetër i rëndësishëm është se në asnjë rast nuk kemi të bëjmë me kërkesa për lirim me kusht që janë dorëzuar para afatit ligjor ndërsa paraqitet shqetësues fakti se disa ankesa u dorëzuan pas afatit ligjor ose pa iu njohur kjo e drejtë të dënuarit dhe konstatimi i konfliktit të interesit dhe mos respektimit të obligimit për përjashtim të anëtarëve të Panelit që i kanë shqyrtuar kërkesat e të dënuarve.

Pjesë e rëndësishme e kësaj analize është edhe përzgjedhja dhe shqyrtimi në detaje i 6 aktvendimeve më specifike sa i përket natyrës së të dënuarit, veprës penale të kryer, kohëzgjatjes së dënimit dhe mënyrës së vendosjes nga Paneli dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Pjesa e fundit ka të bëjë me përmbledhjen e shkurtër të gjetjeve kryesore dhe me rekomandimet specifike për të gjitha institucionet që marrin pjesë në zbatimin e lirit me kusht, si një dobi

---

<sup>1</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti Vjetor 2023, fq. 88, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/0RrTk>

(beneficion) tejet e rëndësishëm për secilin person që është i privuar nga liria e që dënimi ndaj tij ka arritur qëllimet e parapara ligjore.

## I. LIRIMI ME KUSHT SI KONCEPT DHE INSTITUT JURIDIK

Në vendin tonë, ky institut që shërben si stimulim për të dënuarit që të kenë sjellje të mira gjatë mbajtjes së dënimit e të jenë aktiv në programet trajnuese e risocializuese, është i aplikueshëm qysh prej vitit [2002](#), në kohën kur Kosova ishte nën mbikëqyrjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Më pas, Lirimi me Kusht vazhdoi të jetë pjesë e legjislacionit primar, përkatësisht në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP).

Në vitin e kaluar, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) miratoi Rregulloren e re nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, e cila zbatohet lidhur me kërkesat e parashtruara nga të dënuarit tek Institucionet Korrektuese, shqyrtimit të tyre nga ana e Panelit dhe mbikëqyrjes së të liruave me kusht nga Shërbimi Sprovues i Kosovës (ShSK).

Si legjislacioni primar ashtu edhe ky akt nënligjor përcakton se lirimi me kusht vendoset nga Paneli për Lirim me Kusht (tutje: PLK ose Paneli) kurse kompetenca e Gjykatës Supreme të Kosovës është që të trajtojë ankesat e palës së pakënaqur me vendimin e Panelit, në rastet kur kërkesat për lirim me kusht janë refuzuar për një periudhë rishqyrtimi deri në 6 muaj.

Për secilin person që është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe për të njëjtën është shqiptuar dënim me burgim efektiv, ekzekutimi i sanksionit penal fillon kur vendimi e merr formën e prerë, nëse për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore. Burgimi mbahet në burgun e sigurisë së lartë ose në njërën nga qendrat korrektuese në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK).

Ekzekutimi i dënimit, në këtë rast mbajtja e burgimit, sipas legjislacionit në fuqi ka për qëllim të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.<sup>2</sup>

Pra, ashtu siç e specifikon edhe kjo dispozitë, qëllimi i dënimit ndaj një personi që ka kryer veprë penale nuk ka të bëjë me hakmarrjen për veprimin e kundërligjshëm por në preventivën që në të ardhmen mos të bie ndesh me ligjin dhe që i njëjti të rehabilitohet gjatë mbajtjes së dënimit. Përveç qëllimit subjektiv të dënimit, ekzekutimi i sanksionit penal për të dënuarin bëhet edhe me qëllim të preventivës së përgjithshme shoqërore nga veprimet e kundërligjshme që si pasojë kanë dëmtimin apo asgjësimin e të mirave ekonomike dhe rrezikimin e jetës së individëve, si dhe në dhënien e mesazhit që kushdo që nuk respekton ligjin do të përballet me sanksion.

Gjatë mbajtjes së dënimit, secilit të burgosur i njihet e drejta në trajtim human, respektimin e dinjitetit, mosdiskriminimit dhe institucioni korrektues duhet të nxisë sa më shumë që të jetë e mundur pjesëmarrjen e personit të dënuar në risocializimin dhe riintegrimin e tij shoqëror,

---

<sup>2</sup> Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Janar 2019, Neni 38, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/RT7kE>

përmes planifikimit të dënimit dhe planit individual, si dhe bashkëpunimit të shoqërisë në arritjen e qëllimeve të tilla.<sup>3</sup>

Për sjellje të mirë, angazhim në punë dhe pjesëmarrje në trajnime apo programe rehabilituese, të dënuarit përveç se mund t'i jepen beneficione brenda institucionit korrektues<sup>4</sup>, të njëjtat mund të shërbejnë edhe si shkaqe për përfitim nga instituti i lirit me kusht, që nënkupton se i njëjti mund të lirohet nga vuajtja e dënimit me burg para kryerjes në tërësi të tij.

KPRK-ja në dispozitat që rregullon këtë institut parasheh që personi i dënuar mund të lirohet me kusht nëse plotësohen këto parakushte ligjore: sjellja e të dënuarit gjatë mbajtjes së dënimit dhe nëse përmbushet një minimum kohor i mbajtjes së dënimit nga kohëzgjatja totale e saj.

Referuar nenit 90 të KPRK-së, personi i dënuar për veprë penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar. Për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar. Kurse, në rastet kur personi është dënuar me burgim të përjetshëm, ai mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim i shqiptuar. Lirimi me kusht vendoset nga Paneli i themeluar në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), ndërsa periudha minimale e mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues do të jetë së paku pesë (5) vjet.<sup>5</sup>

## **II. PROCEDURA E PARASHTRIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR LIRIM ME KUSHT**

Procedura e cila duhet të ndiqet për parashtrimin e kërkesës për lirim me kusht Rregulloren e re nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht (Rregullorja në fuqi)<sup>6</sup>. Në çdo kohë pas fillimit të mbajtjes së dënimit, zyrtarët e institucionit korrektues e kanë për obligim që të dënuarin ta njoftojnë mbi të drejtat, kushtet dhe procedurat e lirit me kusht, si dhe me datën kur i dënuari e plotëson kushtin për të parashtruar kërkesë pranë Panelit. 30 ditë para se të arrihet data kur personi në vuajtje të dënimit plotëson kushtin kohor për të përfituar nga lirimi me kusht, ai njoftohet me shkrim nga drejtori i institucionit korrektues dhe me pëlqimin e në emër të të dënuarit mund t'i drejtohet Panelit. Më pas, i dënuari paraqet deklaratë për kërkesën për lirim me kusht me tek drejtori i institucionit korrektues, në të cilën arsyeton arritjen e qëllimit të dënimit tek ai. Zyrtari i Shërbimit Sprovues interviston të dënuarin dhe kërkohet nënshkrimi i premtimit që i njëjti nuk do të kryej veprë penale në periudhën e lirit me kusht. 7 ditë para se një person të kualifikohet për lirim me kusht, kërkesa dhe dosja personale e të dënuarit e përgatitur nga Institucioni Korrektues i përcjellët Panelit.

Dosja përfshinë të dhënat për: llojin e veprës penale të kryer nga personi i dënuar, qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës, ndonjë veprë penale të

<sup>3</sup> Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 2022, Neni 6, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/Actgx>

<sup>4</sup> Të drejtën e zgjeruar në pranimin e vizitave duke përfshirë vizitat nga rrethi i gjerë i personave; pranimin e vizitave në institucionin korrektues në prani të mbikëqyrësve, por pa u dëgjuar nga ata; të drejtën e zgjeruar në kalimin e kohës së caktuar në lokale të veçanta me bashkëshortin/en; të drejtën e zgjeruar në kalimin e kohës së caktuar në hapësira të veçanta me fëmijët dhe prindërit; dhe pushim jashtë institucionit korrektues deri në katërmëdhjetë (14) ditë brenda 1 viti.

<sup>5</sup> Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Janar 2019, Neni 90, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/RT7kE>

<sup>6</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Rregullore nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, dhjetor 2023, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/YUmXT>

kryer më parë nga ai, rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore, gjendjen e tij fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vlerësimin e rrezikshmërisë kurdo që konsiderohet e nevojshme nga një psikiatër, apo psikolog, sjelljen e tij në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur në shmangien e faktorëve të veprës penale, planet e tij pas liritimit, përkrahja që mund t'i ofrohet pas liritimit, dhe ndonjë rrethanë që tregon se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.




Fig.1. Procedura e parashtrimit të kërkesës për lirim me kusht

Pasi kërkesa dorëzohet në Panel, ky organ në kuadër të KGJK-së duhet që të ndjekë disa procedura që parashihen për shqyrtimin e kërkesës dhe dosjes së përgatitur nga Institucioni Korrektues. Procedurat kryesore janë paraqitur grafiksht si më poshtë:




Fig. 2. Procedura e shqyrtimit të kërkesës nga Paneli për Lirim me Kusht.

### III. ROLI I GJYKATËS SUPREME TEK RASTET E KËRKESAVE PËR LIRIM ME KUSHT

Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Republikën e Kosovës dhe juridiksioni i saj vlen për të gjithë territorin e vendit. Përveç kompetencave kryesore të përcaktuara me Ligjin për Gjykatat, kësaj instance gjyqësore i është lënë mundësia të ketë edhe kompetenca shtesë të përcaktuara me ligj.<sup>7</sup> Kësisoj, duke ju referuar LESP-së, në rastet kur

<sup>7</sup> Ligji Nr.06/L-054 për Gjykatat, dhjetor 2018, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/6psKQ>

Paneli nuk aprovon kërkesat për lirim me kusht, pala e pakënaqur me vendimin ka të drejtë të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.<sup>8</sup>

Ankesa mund të ushtrohet me pretendimet që janë zbatuar gabimisht dispozitat e LESP-së që kanë të bëjnë me lirim me kusht, janë shkelur procedurat e përcaktuara me ligj dhe në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës.

Pas pranimit të ankesës, Gjykata Supreme, në një trup gjykues të përbërë nga tre (3) anëtarë, të zgjedhur nga Kryetari, brenda tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën. Pas shqyrtimit të ankesës, ky trup gjykues **mund të konfirmojë vendimin e Panelit për lirim me kusht, ta ndryshojë atë, apo ta kthejë për rishqyrtim.**

Me konfirmimin e vendimit të Panelit nënkupton që Gjykata Supreme e refuzon apo e hedhë poshtë ankesën e të dënuarit duke vërtetuar rrethanat faktike dhe arsyetimin ligjor të dhënë nga Paneli. Një nga arsyet për hedhjen poshtë të ankesës mund të jetë edhe për rastet kur Paneli për lirim me kusht e shtynë rastin për rishqyrtim nga gjashtë (6) muaj e tutje, e ndaj vendimeve të tilla përjashtohet e drejta në ankesë.<sup>9</sup>

Ligji i ka dhënë mundësinë Supremes që ta ndryshojë pjesërisht apo në tërësi vendimin e Panelit, e kjo bëhet duke i vlerësuar rrethanat dhe arsyetimin ligjor në vendimmarrje në raport me pretendimet ankimore të palës, e në këtë rast vendimi i Gjykatës Supreme është përfundimtar.

Në rast se Gjykata Supreme vendos ta kthejë çështjen për rishqyrtim, atëherë Paneli për lirim me kusht vendos brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së vendimit si dhe njofton gjykatën me shkrim. Në rast se nuk merret njoftimi brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e kthimit të rastit për rishqyrtim, Gjykata Supreme vendos përfundimisht mbi rastin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

Nga kjo që u tha më lartë shihet se kompetenca e Gjykatës Supreme në raport me kërkesat për lirim me kusht është në shqyrtimin e vendimeve të Panelit përmes ankesave të dorëzuara nga ana e të dënuarve, aprovimin e vendimeve të Panelit, ndryshimin e tyre ose kthimin e rastit në rivendosje. Kur jemi tek rastet që kthehen në rivendosje, legjislacioni i ka dhënë kompetencë që për rastet e tilla të vendos vetë, me kusht që Paneli nuk ka ndërmarrë veprime për të adresuar gjetjet e Gjykatës në raport me rastin e kthyer në rivendosje.

#### **IV. ANALIZË E 27 AKTVENDIMEVE TË GJYKATËS SUPREME TË PUBLIKUARA GJATË PERIUDHËS 1 JANAR – 31 TETOR 2024**

Duke qenë se KGJK viteve të fundit ka bërë hapa konkret në rritjen e transparencës dhe në rolin proaktiv të publikimit të vendimeve gjyqësore, vlerësohet tejte pozitive që vendimet Panelit por edhe ato të Gjykatës për çështjen e lirit me kusht janë publike dhe kjo ka lehtësuar shumë punën e organizatave të shoqërisë civile por edhe të qytetarëve për t'u informuar mbi punën dhe

---

<sup>8</sup> Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 2022, Neni 117, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/Actgx>

<sup>9</sup> Po aty, neni 117



vendosjen e gjyqësorit në këto raste. Në linjë me këtë, për të pasur më të qartë kompetencat e Gjykatës Supreme në raport me rastet e lirimit me kusht dhe mënyrën e vendosjes për ankesat ndaj vendimeve të Panelit, GLPS ka analizuar 27 aktvendime të publikuara në periudhën 1 janar – 31 tetor 2024.<sup>10</sup>

Gjetjet kryesore nga analizimi i këtyre aktvendimeve janë: për 26 nga 27 rastet Gjykata Supreme i ka vlerësuar të drejta vendimet e Panelit për Lirim me Kusht, në një rast ka vendosur për aprovimin e ankesës dhe e ka kthyer në rivendosje, ndërsa nuk ka ndryshuar asnjë nga vendimet e ankimuar të Panelit.

Sa i përket veprës penale për të cilën janë dënuar personat që kanë kërkuar lirim me kusht, prijnë ata të shpallur fajtorë për vepra penale që lidhen me narkotikë, vjedhje, vrasje, armëmbajtje pa leje, korrupsion, rrezikim i trafikut publik etj. Ndër ta edhe një i dënuar për 6 vepra penale (vjedhje të rëndë e mbetur në tentativë, 4 raste të vjedhjes së rëndë dhe për cenim i pa prekshmërisë së banesave dhe objekteve).

Lidhur me kohëzgjatjen e dënimit me burgim të personave që kanë kërkuar lirim me kusht, përkatësisht që i kanë ankimuar vendimet e Panelit, kemi të bëjmë me dënime nga minimumi prej 6 muaj burgim e deri tek një i dënuar më 25 vite burgim.

Arsyet kryesore për refuzimin e kërkesave për lirim me kusht mbeten pesha e veprës penale, mos arritja e risocializimit të plotë, rreziku për recidivizëm dhe nevoja për kohë shtesë për të vlerësuar sjelljen e të dënuarit. Ndërsa, në një rast, arsyeja kryesore pse kërkesa e të dënuarit për lirim me kusht ishte refuzuar kishte qenë fakti se ka rrezikshmëri për vet të burgosurin për shkak se nuk është arritur pajtesë me familjen e viktimës.

LESP ka dhënë mundësinë që të dënuarve që u refuzohet kërkesa për lirim me kusht të kenë të drejtën që, varësisht nga rrethanat e refuzimit, në një afat prej 3 deri në 12 muaj të parashtrojnë sërish një kërkesë të tillë. Lidhur me këtë element, nga 27 aktvendimet e Supremes që janë analizuar rezulton se pjesa më e madhe e vendimeve mbajnë afatin për rishqyrtim prej 3, 4 dhe 5 muaj. Ndërsa në dy raste afati për rishqyrtim ishte më i gjatë se 6 muaj (7 dhe 12 muaj). Kurse, në raport me përgjegjësinë penale të të dënuarve që kanë parashtruar kërkesë për lirim me kusht në Panel e që më pas i janë drejtuar Supremes me ankesë, rezulton se shumica e të dënuarve veprat penale i kanë kryer me dashje, përveç një rast kur vepra penale e vrasjes ishte kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore.

### **Shembuj nga rastet specifike**

Nga 27 aktvendimet e Gjykatës Supreme të publikuara në periudhën 1 janar – 31 tetor 2024, janë përzgjedhur 6 vendime më specifike për analizim më të detajuar dhe për secilën prej tyre do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm përfshirë edhe mangësitë e tyre.

---

<sup>10</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktvendimet: A.A.nr.38/2023; A.A.nr.35/23; A.A.nr.23/2023; A.A.nr.55/2023; A.A.nr.57/2023; A.A.nr.56/2023; A.A.nr.3/2024; A.A.nr.8/2024; A.A.nr.7/2024; A.A.nr.9/2024, A.A.nr.4/2024; A.A.nr.11/2024; A.A.nr.10/2024; A.A.nr.13/2024; A.A.nr.14/2024; A.A.nr.17/2024; A.A.nr.15/2024; A.A.nr.26/2024; A.A.nr.16/2024; A.A.nr.25/2024; A.A.nr.33/2024; A.A.nr.23/2024; A.A.nr.31/2024; A.A.nr.29/2024; A.A.nr.36/2024, A.A.nr.32/2024 dhe A.A.nr.30/2024, të qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/XHPZ9>



I dënuari	Veprat penale	Dënimi me burgim	Dënimi i mbajtur	Raporti Vlerësues i Qendrës Korrektuese	Vendimi dhe arsyetimi i Panelit	Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme
A.Z	Vrasje e rëndë dhe armëmbajtje pa leje	25 vite	16 vite, 8 muaj e 22 ditë	I dënuari gjatë vuajtjes së dënimit ka treguar sjellje të mira dhe se procesi i risocializimit ka ecur pozitivisht.	Refuzim i kërkesës me të drejtë rishqyrtimi pas 12 muajve.  Ende duhet kohë për të vlerësuar sjelljen e të dënuarit në Institucionin Korrektues, pesha e veprës penale dhe nevoja e mbrojtjes së individit dhe shoqërisë nga vepra penale e tillë apo të ngjashme.	Ankesa refuzohet si e palejueshme pasi sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë vetëm në rastet kur afati për rishqyrtim është nën 6 muaj.

Tek ky rast janë nxjerrë tre elemente tejet të rëndësishme. Së pari, ndonëse është konstatimi i Ekipit profesionist i Qendrës Korrektuese se i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit ka treguar sjellje të mira dhe se procesi i risocializimit ka ecur pozitivisht, Paneli në arsyet e refuzimit të kërkesës konstaton se duhet ende kohë për të vlerësuar sjelljet e të dënuarit. Në këtë rast, një konstatim më i duhur nga Paneli do të ishte se nuk është arritur socializim i plotë i të dënuarit sepse konstatimi është që procesi i risocializimit ka ecur pozitivisht, e jo të konstatohet se duhet ende kohë për të vlerësuar sjelljet e të dënuarit. Për faktin se kjo bazohet në konstatimin e Ekipit Profesionist dhe do të ishte e paarsyeshme të konstatohet nevoja për kohë shtesë për të vlerësuar sjelljet e të dënuarit kur ai tashmë ka kaluar më shumë se 16 vite në mbajtje të burgimit.

Së dyti, kurdo që Institucionet Korrektuese pranojnë aktvendimet e Panelit me të cilat është refuzuar kërkesa për lirim me kusht dhe që afati për rishqyrtim është më i gjatë se 6 muaj, t'i njoftojnë apo t'ua rikujtojnë të dënuarve që dispozitat ligjore nuk ua njohin të drejtën e ankesës. Një çështje e tillë do të kishte efekt pozitiv zingjiror si në uljen e shpenzimeve buxhetore të Institucionit Korrektues, në numrin e rasteve që i trajton Gjykata Supreme, e më së shumti në

<sup>11</sup> Gjykata Supreme, Aktvendimi AA.nr.7/2024, i publikuar më 29 mars 2024, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/jTty8>

angazhimin e të dënuarit për përmirësimin e sjelljeve të tij dhe arritjes së risocializimit të plotë deri në arritjen e afatit për rishqyrtim të kërkesës së tij.

Së treti, aktvendimi i Gjykatës Supreme është i publikuar vetëm në gjuhën serbe, ndërsa referuar Udhëzimit Administrativ të KGJK-së<sup>12</sup>, vendimet gjyqësore duhet të jenë të publikuara në gjuhën e përpilimit të aktgjykimit/aktvendimit dhe në versionin e përkthyer. Prandaj, KGJK dhe Gjykata Supreme rekomandohet që të marrin masa konkrete ashtu që vendimet gjyqësore të publikohen së paku në dy gjuhët zyrtare, atë shqipe dhe serbe.

#### Aktvendimi A.A.nr.14/2024<sup>13</sup>

I dënuari	Veprat penale	Dënimi me burgim	Dënimi i mbajtur	Raporti Vlerësues i Qendrës Korrektuese	Vendimi dhe arsyetimi i Panelit	Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme
B.G	Vjedhje të rëndë e mbetur në tentativë; 4 raste të vjedhjes së rëndë; dhe cenim i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve	1 vit e 6 muaj	9 muaj e 18 ditë	I dënuari ka treguar sjellje të mirë dhe i angazhuar në punë. Lidhur me procesin e risocializimit konsiderohet se ka rrjedh kënaqshëm, duke shënuar hapa progresiv.	Refuzim i kërkesës me të drejtë rishqyrtimi pas 5 muajve.  Ende duhet kohë për të vlerësuar sjelljen e të dënuarit në Institutin Korrektues dhe ekziston rreziku i përgjithshëm ndaj komunitetit.	Ankesa refuzohet si e pasafatshme pasi e njëjta ishte dorëzuar në gjykatë 20 ditë pas kalimit të afatit për paraqitjen e ankesës.

Në këtë rast vlen të theksohet se duhet komunikim më proaktiv ndërmjet institucionit korrektues dhe të dënuarit që të njëjtit mos t'i humbet e drejta që i njihet me ligj në ankesë ndaj vendimit të Panelit. Për më tepër, duke qenë se Supremja nuk i shqyrton në merita ankesat e pasafatshme, për shkak të mungesës së këtij komunikimi mes institucionit korrektues e të dënuarit, pretendimet ankimore mund të jenë të bazuara e që mund të ndikojnë edhe në përfitimin e të dënuarit nga instituti i lirimit me kusht, por të njëjtat nuk shqyrtohen fare për shkak se ankesa dorëzohet pas afatit të paraparë ligjor. Do të ishte e nevojshme që në rastet të tilla të shqyrtohej edhe çështja nëse pasafatshmëria e dorëzimit të ankesës ka ndodhur pa fajin e të dënuarit dhe një fakt të tillë ta kishte parasysh Supremja kur vendos përfundimisht mbi ankesën e shqyrtuar.

<sup>12</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për publikimin e aktgjykimeve të përpunuara (i plotësuar me UA 01/2021 dhe UA 01/2022), i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/68Q4r>

<sup>13</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi A.A.Nr.14/2024, i publikuar më 16 korrik 2024, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/ËI4GI>

I dënuari	Veprat penale	Dënimi me burgim	Dënimi i mbajtur	Raporti Vlerësues i Qendrës Korrektuese	Vendimi dhe arsyetimi i Panelit	Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme
F.K	Marrja e ryshfetit	3 vite e 3 muaj	1 vit e 8 muaj	I dënuari ka treguar sjellje të mirë, bashkëpunues me stafin dhe ka arritur risocializimin.	Refuzim i kërkesës me të drejtë rishqyrtimi pas 7 muajve.  Ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal.	Ankesa refuzohet si e palejueshme pasi të dënuarit kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë vetëm në rastet kur afati për rishqyrtim është nën 6 muaj.

Duke qenë se Aktvendimi i Supremes nuk përmban të dhëna sa i përket veprës penale dhe lartësisë së dënimit, këto të dhëna janë siguruar në vendimin e Panelit ([PLK.D.nr.183/24](#)). Në këtë rast Paneli për lirim me kusht të dënuarit ia ka refuzuar kërkesën për lirim me kusht dhe njëherit në vendim ka konstatuar se refuzimi ka të bëjë me periudhën prej 7 muajve dhe se e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati. Mbi këtë bazë Gjykata Supreme ka gjetur se ankesa e paraqitur nga i dënuari F. K., duhet të hedhet poshtë si e palejuar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në rastin konkret, njësoj si në Aktvendimin A.A.Nr.7/2024, përsërisim rëndësinë që Institucionet Korrektuese kurdo që pranojnë aktvendimet e Panelit me të cilat është refuzuar kërkesa për lirim me kusht dhe që afati për rishqyrtim është më i gjatë se 6 muaj, t'i njoftojnë apo t'ua rikujtojnë të dënuarve që dispozitat ligjore nuk ua njohin të drejtën e ankesës.

Tutje, vendimi i Panelit vlerësohet kundërthënës sa i përket mënyrës së si e ka trajtuar raportin e ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese, i cili thekson se është arritur risocializimi, pra një nga kriteret bazë për të përfituar nga instituti i lirimit me kusht. Në anën tjetër, Paneli vendosi që të refuzojë kërkesën duke theksuar se nuk është arritur ky qëllim në periudhën e mbajtjes së dënimit. Nëse në këtë rast, Paneli do të vendoste një afat më pak se 6 muaj për rishqyrtim të kërkesës, pretendimet e palës për çështjen e konfliktit të interesit si dhe kundërthëniet në mes konstatimeve të ekipit profesional të Qendrës Korrektuese dhe arsyeve të refuzimit të kërkesës nga Paneli, Supremja do të kishte bazë të mjaftueshme që këtë rast ta kthente në rishqyrtim.

<sup>14</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi A.A.Nr.17/2024, i publikuar më datë 22 korrik 2024, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/nbhdy>

Aktvendimi A.A.nr.30/2024<sup>15</sup>

I dënuari	Veprat penale	Dënimi me burgim	Dënimi i mbajtur	Raporti Vlerësues i Qendrës Korrektuese	Vendimi dhe arsyetimi i Panelit	Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme
G.S	Dy vepra penale: “Blerje, posedimi shpërndarja dhe shitje e pa autorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge	3 vite e 2 muaj	2 vite e 6 muaj	I dënuari ka përmirësuar sjelljet e tij, nuk ka shkelje të reja disiplinore, i angazhuar me punë, nuk është person bashkëpunues, rrezikshmëri e mesme për komunitetin dhe mbajtja e dënimit të i dënuari po ka efekt pozitiv.	Refuzim i kërkesës me të drejtë rishqyrtimi pas 3 muajve.  Duhet ende kohë për të mbajtur dënimin në mënyrë që të vlerësohet sjellja e të njëjtit; ekziston rrezikshmëria për komunitetin; nuk është arritur risocializimi i plotë	Ankesa aprovohet. Anulohet aktvendimi i Panelit dhe lënda i kthehet organit të njëjtë në rivendosje. Zëvendës kryesuesi i këtij paneli është dashtë të përjashtohet nga procedura e shqyrtimit dhe vendosjes pasi ka marrë pjesë si kryetar i kolegjit në lëndën e vendosur në Gjykatë Supreme.

LESP-ja dhe Rregullorja përcaktojnë rregulla konkrete sa i përket çështjes së konfliktit të interesit dhe përjashtimit të Kryesuesit dhe anëtarëve të Panelit në shqyrtimin e kërkesave për lirim me kusht.<sup>16</sup> Një nga këto kritere është që gjyqtari që është kryesues ose anëtar i Panelit, përjashtohet nga shqyrtimi i kërkesës në çështjen e njëjtë penale ku ka marrë pjesë në procedurë si gjyqtar, prokuror, mbrojtës, i dëmtuar, përfaqësues ligjor apo i autorizuar i të dëmtuarit, dëshmitar ose ekspert.

Në trajtimin e kërkesës për lirim me kusht në rastin konkret shohim se në përbërjen e Panelit ka marrë pjesë edhe gjyqtari që e ka trajtuar të njëjtën lëndë si kryetar i trupit gjykues në Gjykatën Supreme. Duke pasur parasysh që Paneli respekton afatet për trajtimin e kërkesave për lirim me kusht, duhet të ketë parasysh obligimin ligjor që në çdo situatë t'i shmanget rasteve kur përmbushen elementet e konfliktit të interesit apo kur ekzistojnë rrethana të tjera që e vënë në dyshim objektivitetin e anëtarit të Panelit. Mos ndërmarrja e këtyre masave rezulton me kthim të çështjeve në rivendosje e rrjedhimisht edhe në vonesën ose humbjen e të drejtës së të dënuarve nga instituti i lirimit me kusht.

<sup>15</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi A.A.nr.30/2024, i publikuar më datë 6 tetor 2024, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/71v4G>

<sup>16</sup> Shih më shumë nenin 17 të Rregullores Nr.12/2023, e qasshme në linkun: <https://shorturl.at/h6VJK>

I dënuari	Veprat penale	Dënimi me burgim	Dënimi i mbajtur	Raporti Vlerësues i Qendrës Korrektuese	Vendimi dhe arsyetimi i Panelit	Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme
A.M	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	6 muaj	4 muaj e 14 ditë	I dënuari ka treguar sjellje të mirë dhe i angazhuar me punë, risocializimi ka arritur, dhe tani është i gatshëm që të riintegrohet në familje dhe shoqëri si person i dobishëm.	Refuzim i kërkesës pa të drejtë rishqyrtimi. Arsyet: rrezikshmëria e përgjithshme shoqërore dhe mos arritja e risocializimit të plotë.	Refuzohet ankesa. Gjykata Supreme e Kosovës pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e ankimuar, pasi që i njëjti është në tërësi i bazuar në ligj.

Lidhur me këtë rast, shihet se as Paneli e as Gjykata Supreme nuk i kanë marrë parasysh raportet e tjera të përpiluara nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, ku rezulton se *i dënuari ka treguar sjellje të mirë dhe i angazhuar me punë. Sipas ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese, për procesin e risocializimit është konstatuar se mbajtja e dënimit ka ndikuar në përmirësimin e tij të përgjithshëm dhe se risocializimi ka arritur, dhe tani është i gatshëm që të riintegrohet në familje dhe shoqëri si person i dobishëm.* Në kundërshtim me këto konstatime, [Paneli](#) duke e arsyetuar mos arritjen e risocializimit dhe rrezikshmërisë së përgjithshme shoqërore. Ky interpretim i gabuar i gjendjes faktike e rrjedhimisht anashkalimi i tërësishëm i gjetjeve të raporti nga ekipi profesional i Qendrës Korrektuese ka rezultuar edhe në mohimin e të drejtës së të dënuarit nga lirimi me kusht.

<sup>17</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi A.A.Nr.26/2024, i publikuar më datë 12 gusht 2024, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/Ytrzq>

I dënuari	Vepra penale	Dënimi me burgim	Dënimi i mbajtur	Raporti Vlerësues i Qendrës Korrektuese	Vendimi dhe arsyetimi i Panelit	Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme
M.S	Rrezikim i trafikut publik	2 vite e 6 muaj	1 vit e 4 muaj	I dënuari ka treguar sjellje të mirë, bashkëpunues me stafin, angazhuar me punë, ndjehet i penduar, shpreh keqardhje për viktimën, por ende ka rrezikshmëri për vet të burgosurin për shkak se nuk është arritur pajtesë me familjen e viktimës.	Refuzim i kërkesës në afat prej 5 muajve me të drejtë rishqyrtimi. Arsyet: Rrezikshmëria e mbetur ndaj vet të burgosurit si dhe koha e mbetur për mbajtje të dënimit	Refuzohet ankesa. Gjykata Supreme e Kosovës pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e ankimuar, pasi që i njëjti është në tërësi i bazuar në ligj.

Pra, vlerësohet tejet pozitive që si Qendra Korrektuese, [Paneli](#) e Supremja në rastin konkret i kanë kushtuar rëndësi një fakti tejet të rëndësishëm, përkatësisht zakonit shoqëror të pajtimit ndërmjet familjes së të dënuarit dhe familjes së viktimës, për të mbrojtur të dënuarin nga rreziku potencial që mund t'i kanoset në rast se lirohet me kusht. Kjo është në linjë edhe me një nga qëllimet kryesore të dënimit që të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

## V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### **Efektiviteti i Panelit për Lirim me Kusht**

- Nga analizimi i 27 aktvendimeve, rezulton se në shumicën e rasteve Gjykata Supreme ka konfirmuar vendimet e Panelit, duke konstatuar se vendimmarrjet janë kryesisht në përputhje me legjislacionin dhe gjendjen faktike.

### **Mungesa e uniformitetit në vlerësim**

- Disa vendime të Gjykatës Supreme dhe të Panelit për Lirim me Kusht janë vlerësuar si të paqarta ose kundërthënëse në arsyetimin e tyre, veçanërisht kur nuk janë marrë në konsideratë raportet vlerësuese të ekipeve profesionale nga qendrat korrektuese.

<sup>18</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Aktvendimi A.A.Nr.26/2024, i publikuar më datë 12 gusht 2024, i qasshëm në linkun: <https://shorturl.at/RCjQ6>

### **Përbërja e Panelit në kundërshtim me ligjin**

- Është evidentuar një rast ku përbërja e Panelit ka qenë në kundërshtim me rregullat mbi konfliktin e interesit, duke rezultuar në kthimin e çështjes për rivendosje.

### **Nevoja për informim të të dënuarve për të drejtat dhe afatet**

- Në disa raste është vënë re mungesa e informimit të të dënuarve mbi të drejtat për ankesë ose afatet e përcaktuara, duke çuar në humbjen e mundësive për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore.

### **Arsyet më të shpeshta për refuzimin e kërkesave për lirim me kusht**

- Refuzimet më të shpeshta për lirim me kusht bazohen në peshën e veprës penale, rrezikshmërinë për recidivizëm dhe mos arritjen e risocializimit të plotë.

### **Mos respektimi i detyrimit ligjor për përdorimi e gjuhëve zyrtare**

- Vetëm një nga aktvendimet e publikuara është në të dyja gjuhët zyrtare, duke treguar nevojën për përmirësim në zbatimin e obligimeve ligjore mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare.

### **Rekomandime**

- Instituti i lirimimit me kusht duhet të jetë shtysë që të dënuarit të kenë sjellje të mira gjatë mbajtjes së dënimit, të ndjekin programet trajnuese e që rehabilitimi i tyre të arrijë në shkallën që ata të jenë të gatshëm t'i kthehen jetës normale dhe që të mos bien ndesh më me ligjin. Kjo mund të arrihet duke ofruar programe adekuate për të dënuarit, mbikëqyrje të shtuar nga zyrtarët korrektues, informim sistematik mbi benefitet që mund t'i kenë nga lirimi me kusht dhe që këta persona t'i kthehen shoqërisë si resurs dhe shembull për arritjen e të gjitha qëllimeve të dënimit.
- Institucionet Korrektuese duhet të vazhdojnë që në kohë sa më të arsyeshme e sa më shpesh t'i njoftojnë të dënuarit mbi lirimin me kusht dhe për afatet që lidhen me kërkesën dhe ankesën në raport me të drejtën e shfrytëzimit të këtij instituti të së drejtës penale.
- Po ashtu, t'i kushtohet kujdes i veçantë raporteve të përgatitura nga ekipi profesional mbi të dënuarin, pasi të njëjtat paraqesin një bazë tejet të rëndësishme mbi të cilën varet aprovimi apo refuzimi i kërkesës për lirim me kusht nga ana e Panelit apo e Gjykatë Supreme.
- Paneli për Lirim me Kusht të ketë parasysh që para çdo shqyrtimi të kërkesës për lirim me kusht fillimisht të konstatojë nëse përbërja e Panelit është në përputhje me kushtet ligjore. Në rast se ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit apo që e determinojnë përjashtimin e anëtarit, kjo të ndodh menjëherë sepse në të kundërtën përveç që kemi të bëjmë me një vendim të marrë në kundërshtim me ligjin, i njëjti ka pasojë edhe në mohimin apo vonesën që i bëhet të dënuarit për përfitim nga lirimi me kusht.
- Paneli duhet të arsyetojë mirë dhe qartë rrethanat që qojnë tek aprovimi apo refuzimi i kërkesave për lirim me kusht, dhe ky arsyetim duhet të mbështetet në raportin e ekipit profesional të Qendrës Korrektuese, që pas kritereve ligjore, është baza më e rëndësishme mbi të cilën varet e drejta e të dënuarit për t'u liruar me kusht.
- Gjykata Supreme e Kosovës rekomandohet që të shqyrtojë më detajisht rastet e refuzimit të lirimimit me kusht nga Paneli dhe në çdo rast kur plotësohen kushtet ligjore ta ndryshojë vendimin e ankimuar ose të njëjtin ta kthej për rishqyrtim.



- Në rastet kur ankesa ndaj vendimeve të Panelit dorëzohet pas afatit, rekomandohet që Supremja të vlerësoj çështjen nëse pasafatshmëria e dorëzimit të ankesës ka ndodhur pa fajin e të dënuarit dhe një fakt të tillë ta ketë parasysh kur vendos përfundimisht mbi ankesën e shqyrtuar.
- Paneli dhe Gjykata Supreme rekomandohet që të respektojnë obligimin që rrjedh nga aktet ligjore dhe nënligjore sa i përket obligimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare në vendimet që i publikojnë në ueb faqen e KGJK-së.
- Rekomandohet që Gjykata Supreme të kujdeset që aktvendimet për rastet e lirimit me kusht të jenë të unifikuar sa i përket të dhënave që i përmbajnë, me theks të veçantë të dhënave për veprën penale dhe lartësinë e dënimit.

